

VENDIM
Nr. 7, datë 6.1.2020

PËR KUSHTET DHE PROCEDURËN PËR SHPRONËSIMET DHE/OSE
SHKËMBIMIN E PRONËS, PËR INTERES PUBLIK, NË FUNKSION TË
PROCESIT TË RINDËRTIMIT

(Ndryshuar me vendimin nr. 170, datë 17.3.2021)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 32, të ligjit nr. 97/2019, “Për miratimin e aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, ‘Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore’” me propozimin e ministrit të Drejtësisë, ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
PROCEDURA E SHPRONËSIMIT DHE/OSE SHKËMBIMIT NË
FUNKSION TË RINDËRTIMIT

1. Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave dhe i procedurave të shpronësimit të pronës private, për interes publik, në kuadër të procesit të rindërtimit, që zbatohen për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore dhe për zbatimin e programeve të procesit të rindërtimit si dhe përcaktimi i rregullave për shkëmbimin e pasurive, pronë private, me një pasuri tjetër aktuale/ekzistuese ose të ardhshme të paluajtshme në pronësi të shtetit, që krijohet në kuadër të procesit të rindërtimit.

2. Në funksion të procesit të rindërtimit, pronarët e trojeve dhe të banesave që përfshihen në zonat e planifikuara për ndërtim ose në zonat e reja për zhvillim, subjekte private, mund të shpronësohen, për interes publik, duke u kompensuar në vlerë ose nëpërmjet shkëmbimit të pasurisë private me një pasuri tjetër të paluajtshme, në pronësi të shtetit, aktuale ose të ardhshme ose nëpërmjet kombinimit të kompensimit në vlerë me shkëmbimin e pronës private me një pasuri shtetërore aktuale ose të ardhshme, në përputhje me parashikimet e aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, si dhe procedurën e parashikuar në këtë vendim. Janë subjekte të këtij vendimi dhe individët apo familjet që kanë pësuar dëme në banesat e tyre dhe/ose kanë mbetur të pastrehë si pasojë e fatkeqësisë natyrore edhe pse mund të kenë përfituar nga një program tjetër i procesit të rindërtimit.

Këto subjekte, në këto raste, nuk trajtohen si persona të prekur nga fatkeqësia, por si pronarë të pasurive private që nuk janë dëmtuar nga fatkeqësia, por që, për efekt të përballimit të pasojave të shkaktuara nga fatkeqësia, pronat e tyre duhen shfrytëzuar për llogari të programeve të rindërtimit.

3. Shpronësimi dhe/ose shkëmbimi i pasurisë, pronë private, në funksion të procesit të rindërtimit, sipas këtij vendimi, realizohet duke garantuar transparencën, barazinë e shtetasve dhe mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të tyre pasurore.

4. Kërkesa për nisjen e procesit për shpronësimin dhe/ose shkëmbimin bëhet nga njësia zbatuese, pranë ministrisë përgjegjëse për shpronësimin (autoriteti përgjegjës).

5. Kërkesa për nisjen e procedurës së shpronësimit dhe/ose të shkëmbimit duhet të shoqërohet me:

a) vendimin e Këshillit të Ministrave për shpalljen e zonës së re për zhvillim ose dokumentin e planifikimit të territorit, në përputhje me aktin normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, si dhe të dhënat për projektin/projektet që do të realizohen;

b) propozimin nëse shpronësimi kryhet duke kompensuar në vlerë ose duke shkëmbyer pasurinë private me një pasuri tjetër aktuale ose të ardhshme të paluajtshme, në pronësi të shtetit, ose si një kombinim i shpronësimit në vlerë me shkëmbimin e pronës private me një pasuri shtetërore aktuale ose të ardhshme;

c) nëse kërkohet dhe shkëmbimi i pronës private me një pasuri tjetër në pronësi të shtetit, aktuale ose të ardhshme ose kompensimi si një kombinim i shpronësimit në vlerë me shkëmbimin e pronës private me një pasuri shtetërore aktuale ose të ardhshme, propozimi duhet të shoqërohet me relacionin përkatës, ku përcaktohen pjesët takuese të subjektit/subjekteve privat/e në objektin që do të zhvillohet, të cilat janë në dispozicion për shkëmbim. Në rast se shkëmbimi i pronës private bëhet me një pronë shtetërore ekzistuese, relacioni shoqërohet dhe me aktin e pronësisë të pasurisë shtetërore;

ç) aktet që vërtetojnë mënyrën e realizimit të projektit, nga vetë kërkuesi i shpronësimit apo të shkëmbimit si dhe afatet përkatëse;

d) dokumentacionin lidhur me burimin dhe garantimin e fondeve financiare të nevojshme për realizimin e projektit, duke përfshirë edhe ato të shpronësimit dhe/ose të shkëmbimit;

dh) listën e pronarëve të pasurive, pronë private, për të cilat kërkohet shpronësimi dhe/ose shkëmbimi, sipërfaqen e këtyre pasurive, vlerësimi paraprak të tyre si dhe masën e shpërblimit që parashikohet për secilin pronar privat, listën e personave të tretë që duhet të kompensohen për të drejtat e tyre mbi pasurinë, pronë private, që kërkohet të shpronësohet apo të shkëmbehet së bashku me shpërgjimet dhe të dhënat e nevojshme.

6. Brenda 2 (dy) ditëve pune nga paraqitja e kërkesës për shpronësim publik ose shkëmbimin e pasurisë private me pasuri shtetërore, autoriteti përgjegjës për zhvillimin e procedurës së shpronësimit urdhëron ngritjen e komisionit të posaçëm për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit të përshpejtuar.

7. Komisioni ka në përbërjen e tij një anëtar nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën, një anëtar nga ministria përgjegjëse për bujqësinë, një anëtar nga ministria përgjegjëse për financat dhe ekonominë, dy anëtarë nga njësia e vetëqeverisjes vendore në të cilën do të zbatohet programi i rindërtimit, një anëtar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, një anëtar nga njësia zbatuese në kuptim të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e fatkeqësive natyrore”, të tillë si ekonomistë, juristë, inxhinierë. Ministrinë përkatëse, sipas kësaj pike, caktojnë menjëherë përfaqësuesit e tyre në komisionin e posaçëm dhe ia bëjnë me dije autoritetit përgjegjës. Kryetari i komisionit të posaçëm caktohet nga autoriteti përgjegjës për shpronësimin.

8. Anëtarët e komisionit të posaçëm nuk duhet të jenë në konflikt interesi me pronarët që do të shpronësohen. Komisioni ushtron veprimtarinë e tij ekzekutive në mënyrë kolegjiale.

9. Brenda 5 (pesë) ditëve pune nga ngritja e tij, komisioni shqyrton dhe verifikon kërkesën e paraqitur nga kërkuesi dhe, në rast se kërkesa dhe dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë ose i saktë, komisioni i kërkon atij plotësimin e dokumentacionit, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga marrja dijeni. Çdo institucion vë në dispozicion të kërkuesit dhe/ose të komisionit të posaçëm të shpronësimit dokumentacionin ose informacionin e kërkuar, jo më vonë se 2 (dy) ditë nga marrja dijeni e kërkesës.

10. Komisioni, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga momenti i paraqitjes së kërkesës, sipas pikës 4, të këtij vendimi, ose nga momenti i plotësimit të dokumentacionit, verifikon vlerën e pasurisë që shpronësohet, sipas rregullave të mëposhtme:

a) vlera e tokës dhe e ndërtesës që shpronësohet dhe/ose shkëmbehet përlogarit duke iu referuar çmimeve që zbatohen në procedurat për shpronësimin me interes publik, sipas legjislacionit në fuqi;

b) në vlerësimin e pasurive, pronë private, që shpronësohen dhe/ose shkëmbehen, sipas natyrës së tyre, merren parasysh vlera fillestare e tyre, amortizimi, destinacioni, vendndodhja e objektit, indekset e ndryshimit të çmimeve të tregut dhe të monedhës.

11. Në përfundim të verifikimeve të nevojshme dhe të procedurave të parashikuara në pikat e mësipërme, kur kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë vendim, komisioni i posaçëm mund të vendosë:

a) shpronësimin, për interes publik, duke kompensuar në vlerë;

b) shkëmbimin me pasurinë private me një pasuri tjetër të paluajtshme në pronësi të shtetit, aktuale ose të ardhshme; ose

c) shkëmbim të pronës private me një pasuri shtetërore aktuale ose të ardhshme dhe kompensim në vlerë dhe ia njofton menjëherë me shkrim subjektin kërkues në favor të të cilit bëhet shpronësimi dhe/ose shkëmbimi.

12. Brenda 5 (pesë) ditëve nga data e njoftimit të pranimit të kërkesës për shpronësim dhe/ose shkëmbim, ndërmjet njësisë zbatuese në favor të të cilit kërkohet të bëhet shpronësimi dhe/ose shkëmbimi dhe autoritetit përgjegjës, lidhet një marrëveshje për të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella.

13. Autoriteti përgjegjës për zhvillimin e procedurave të shpronësimit dhe/ose të shkëmbimit, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e lidhjes së marrëveshjes me njësinë zbatuese, fillon procedurat e njoftimit të secilit pronar ose bashkëpronar të pasurive, pronë private, që kërkohet të shpronësohen dhe/ose të shkëmbehen sipas parashikimeve të këtij vendimi si dhe personave të tretë lidhur me kompensimin e tyre.

14. Paralelisht me procedurat e njoftimit, sipas pikës 13, të këtij kreu, autoriteti përgjegjës publikon në Fletoren Zyrtare, si dhe në portalin unik qeveritar për rindërtimin kërkesën për shpronësim, për interes publik, dhe/ose për shkëmbim sipas parashikimeve të këtij vendimi, së bashku me vlerësimin paraprak të pronës private si edhe të pronës shtetërore aktuale ose të ardhshme që përfitohet nga shkëmbimi.

15. Pronarët privatë ose personat e tretë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit apo e publikimit, sipas pikave 13 e 14, të këtij kreu, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentet përkatëse pranë autoritetit përgjegjës, duke u shprehur nëse pranojnë kalimin vullnetar të pronësisë me kushtet e ofruara. Komisioni i posaçëm shqyrton pretendimet e kërkuesve, brenda 3 (tri) ditëve nga marrja e tyre.

16. Autoriteti përgjegjës, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e përgjigjes nga i njoftuari, por në çdo rast jo më përpara se 1 (një) muaj nga data e fundit e afatit të publikimit të kërkesës, sipas pikës 14, të këtij kreu, në rastet kur të njoftuarit kanë pranuar kushtet e ofruara prej autoritetit shtetëror apo kur komisioni i posaçëm i ka gjetur si të drejta edhe pretendimet e paraqitura prej tyre, kryen me të njoftuarit, sipas rastit, veprimet për lidhjen e marrëveshjeve përkatëse për shkëmbimin e pronës private me një pasuri shtetërore.

17. Në përfundim të procesit, komisioni i shpronësimit i paraqet autoritetit përgjegjës dokumentacionin e kryerjes së procedurës së shpronësimit dhe/ose të shkëmbimit, i cili ia përcjell për miratim Këshillit të Ministrave, pas marrjes së miratimit nga Komiteti Shtetëror i Rindërtimit.

18. Propozimi shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) relacionin përmbledhës për qëllimin, shkakun dhe nevojën e shpronësimit dhe/ose të shkëmbimit, për afatin e fillimit dhe të mbarimit të shpronësimit dhe/ose të shkëmbimit, si dhe për afatin e fillimit e të përfundimit të punimeve ose të realizimit të qëllimit të shpronësimit dhe/ose të shkëmbimit;

b) dokumentet që kanë shoqëruar procedurën e shpronësimit dhe/ose të shkëmbimit;
c) listën përfundimtare të pronarëve të pasurive që shpronësohen dhe/ose pronat e të cilëve shkëmbehen me pronë shtetërore;

ç) dokumentacionin e vlerësimit të pasurive që shpronësohen dhe/ose shkëmbehen, listën e pronave që do të shkëmbehen dhe marrëveshjen paraprake me pronarët private, sipas këtij vendimi, nëse ka.

19. Masa e kompensimit u jepet ose u vihet në dispozicion, përkatësisht, të shpronësuarit, pronarit apo personit të tretë, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e vendimit të shpronësimit dhe/ose të shkëmbimit ose nga data që ka marrë formë të prerë vendimi i gjykatës. Autoriteti përgjegjës kalon vlerën e kompensimit në një llogari të posaçme bankare të subjektit përfitues.

20. Ankimet kundër vendimit për shpronësimin bëhen në gjykatën kompetente, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ankimet nuk pezullojnë vijimin e procedurave, sipas këtij vendimi.

KREU II

RREGULLA PËR SHKËMBIMIN E PRONËS, REGJISTRIMIN E PRONËS NË REGJISTRIN E PASURIVE TË PALUAJTSHME, STREHIMI I PRONARËVE PRIVATË

1. Kur njësia zbatuese ka kërkuar dhe komisioni i shpronësimit ka vendosur shkëmbimin e pasurisë private me një pasuri tjetër të paluajtshme në pronësi të shtetit, aktuale ose të ardhshme, dhe/ose kompensimin si një kombinim i shpronësimit në vlerë me shkëmbimin e pronës private me një pasuri shtetërore aktuale ose të ardhshme, masa e kompensimit vendoset sipas rregullave të këtij kreu.

2. Shkëmbimi i pronës private, shtëpi individuale banimi dhe truall funksional, kur zona e re për zhvillim realizohet nëpërmjet ndërtimit të ndërtesave me njësi banimi (pallat) ose me shtëpi individuale banimi:

a) në rast se prona private është shtëpi individuale banimi dhe truall funksional i shtëpisë, në territor urban (qytet) dhe territor rural (fshat) pronari privat kompensohet me sipërfaqe ndërtimi banesë në ndërtesën (pallat) ose shtëpi individuale banimi, pasuri shtetërore ose e ardhshme, sa sipërfaqja në metër katrorë e shtëpisë që ka në pronësi. Kompensimi me sipërfaqe ndërtimi banimi kryhet në përputhje me strukturën e njësive të banimit apo të shtëpive individuale të banimit, pronë shtetërore;

b) për truallin në pronësi, pronari privat kompensohet në vlerë në masën që përlogaritet nga komisioni i shpronësimit duke iu referuar çmimeve që zbatohen në procedurat për shpronësimin me interes publik, sipas legjislacionit në fuqi ose me sipërfaqe ndërtimi banimi në ndërtesën (pallat) apo shtëpi individuale banimi që i korrespondon vlerës së kompensimit të truallit. Në këtë rast, vlera e sipërfaqes së ndërtimit përlogaritet duke përdorur si bazë çmimet e miratuara me vendim nga Enti Kombëtar i Banesave në fuqi në kohën e shpronësimit ose të shkëmbimit;

c) në rast të mospërputhjeve si pasojë e strukturës së njësive të banimit apo të shtëpive individuale të banimit, kur rezultojnë sipërfaqe shtesë në pronën me të cilët kompensohet, pronari privat paguan për çdo metër kator shtesë çmimin e miratuar me vendim nga Enti Kombëtar i Banesave në fuqi në kohën e shpronësimit ose të shkëmbimit.

3. Shkëmbimi i pronës private, truall në territor urban (qytet) ose në territor rural (fshat):

a) në rast se prona private është vetëm truall në territor urban (qytet) ose në territor rural (fshat) pronari privat kompensohet në vlerë në masën që përlogaritet nga komisioni i shpronësimit, duke iu referuar çmimeve që zbatohen në procedurat për shpronësimin, me interes publik, sipas legjislacionit në fuqi, ose me sipërfaqe ndërtimi banimi në ndërtesën (pallat) ose shtëpi individuale banimi që i korrespondon vlerës së kompensimit të truallit;

b) në rast kompensimi të vlerës së truallit me sipërfaqe banimi, vlera e sipërfaqes së ndërtimit përlllogaritet duke përdorur si bazë çmimet e miratuara me vendim nga Enti Kombëtar i Banesave në fuqi në kohën e shpronësimit ose shkëmbimit;

c) në rast të mospërputhjeve si pasojë e strukturës së njësisë së banimit ose shtëpisë individuale të banimit në zonën e re, kur rezultojnë sipërfaqe shtesë në pronën me të cilën kompensohet, pronari privat paguan për çdo metër katror shtesë çmimin e miratuar me vendim nga Enti Kombëtar i Banesave në fuqi në kohën e shpronësimit ose shkëmbimit.

4. Shkëmbimi i pronës private, tokë bujqësore:

a) për pronarët në territor rural, kur prona është vetëm tokë bujqësore dhe përfshihet në zonën e re për zhvillim, shkëmbimi bëhet po me tokë bujqësore në pronësi të shtetit, në territorin e së njëjtës njësi vendore ku ndodhet prona private që shkëmbehet, me të njëjtën sipërfaqe në pronësi private të përfituesit që shfrytëzohet për ndërtimet e reja;

b) njësitë zbatuese bashkëpunojnë me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe ministrinë përgjegjëse për bujqësinë, për plotësimin e detyrimeve që parashikohen në shkronjën “a”, të pikës 4, të këtij vendimi, dhe i përcjellin informacion të plotë autoritetit përgjegjës mbi shkëmbimin me tokë bujqësore nëpërmjet dokumentacionit që shoqëron kërkesën për nisjen e procedurës së shpronësimit dhe/ose të shkëmbimit;

c) në rast të pamundësisë për ta pajisur pronarin privat me tokë bujqësore, sipas parashikimeve të pikës 4, të këtij kreu, pronari privat kompensohet në vlerë në masën që përlllogaritet nga komisioni i shpronësimit, duke iu referuar çmimeve që zbatohen në procedurat për shpronësimin, me interes publik, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Shkëmbimi i pronës private, njësi banimi (apartament) me pronë në zonën e re për zhvillim:

a) pronarët privatë që kanë në pronësi njësi banimi (apartamente) në ndërtesa banimi (pallate) në territor urban (qytet) ose territor rural (fshat), do të përfitojnë në shkëmbim të pasurive të tyre njësi banimi (apartamente) në ndërtesat që realizohen në zonën e re për zhvillim ose shtëpi individuale banimi në zonën e re për zhvillim sa sipërfaqja e banesës që kanë, në përputhje me strukturën e njësive të reja të banimit (apartamenteve) ose shtëpive individuale dhe truallin funksional të tyre që ndërtohen në zonën e re për zhvillim;

b) në rast të mospërputhjeve si pasojë e strukturës së shtëpisë individuale të banimit ose të njësisë së banimit (apartament), kur rezultojnë sipërfaqe shtesë në pronën me të cilën kompensohet pronari privat si pasojë e shkëmbimit, pronari privat paguan për çdo metër katror shtesë çmimin e miratuar me vendim nga Enti Kombëtar i Banesave në fuqi në kohën e shpronësimit ose të shkëmbimit. Për pagesën e truallit, të shtëpisë individuale të banimit, pronari privat paguan çmimin për metër katror, sipas legjislacionit në fuqi për llogaritjen e vlerës së tokës.

6. Prona private, njësi tregtimi:

a) pronarët privatë, që kanë në pronësi njësi tregtimi në zonën e re për zhvillim, kompensohen me vlerë në masën që përlllogaritet nga komisioni i shpronësimit, duke iu referuar çmimeve që zbatohen në procedurat për shpronësimin, për interes publik, sipas legjislacionit në fuqi; ose

b) me pëlqimin e tyre, pronarët privatë që kanë në pronësi njësi tregtimi në zonën e re për zhvillim, kompensohen nëpërmjet shkëmbimit të Së drejtës së pronësisë mbi njësinë e tregimit me fitimin e pronësisë mbi një njësi banimi ose njësi tregtimi, nëse ka, me të njëjtën sipërfaqe në metër katror sa njësia e tregimit që kishin në pronësi;

c) në rast se, për shkak të strukturës së njësisë së tregimit, njësisë së banimit ose shtëpisë individuale të banimit në zonën e re, rezultojnë sipërfaqe shtesë në pronën me të cilën kompensohet, pronari privat paguan për çdo metër katror shtesë çmimin e miratuar me vendim nga Enti Kombëtar i Banesave në fuqi në kohën e shpronësimit ose të shkëmbimit. Në rast se, për shkak të strukturës së njësisë së tregimit, njësisë së banimit ose shtëpisë individuale të banimit në zonën e re rezultojnë sipërfaqe më të vogla, në pronën me të cilën kompensohet, pronari privat ka të drejtë të kompensohet, për pjesën e mbetur të sipërfaqes, në përputhje me shkronjën “a”, të kësaj pike.

7. Në rast se pronari privat pranon kushtet, sipas parashikimeve të këtij vendimi, lidhet marrëveshja përkatëse siç parashikohet në pikën 16, të kreut II, të këtij vendimi, që shoqërohet edhe nga deklarata noteriale për heqjen dorë nga e drejta e përfitimit të vlerës së kompensimit në të holla dhe nga çdo pretendim në lidhje me pronën private. Kontrata hartohet nga autoriteti përgjegjës në bashkëpunim me njësinë zbatuese dhe përmban, përveç të tjerave, dhe kushtet e rregullat për pagesat që kryen pronari privat në rast të sipërfaqeve shtesë në ndërtimin e ri dhe marrjen në dorëzim të pronës. Autoriteti përgjegjës, në marrëveshjen që lidh me pronarin privat, vepron si përfaqësues i organit përkatës publik që gëzon ose do të gëzojë në të ardhmen tagrin e pronarit të pronës shtetërore që shkëmbehet, në bazë të autorizimit përkatës ose të parashikimeve të marrëveshjes që përcaktohet në pikën 12, të kreut II, të këtij vendimi.

8. Në rastin e shkëmbimit të pronës private me pronë shtetërore ekzistuese, pasuria shtetërore regjistrohet në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, sipas legjislacionit në fuqi, në pronësi të pronarit privat jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e vendimit të shpronësimit dhe/ose të shkëmbimit ose nga data që ka marrë formë të prerë vendimi i gjykatës, me kërkesë të njësisë zbatuese dhe/ose të përfaqësuesit të pronarit shtet. Kur pronari/pronarët privat/ë ka/në pranuar kushtet e shkëmbimit, pjesë e kërkesës për regjistrim janë dhe aktet e kalimit të pronësisë ose marrëveshjet sipas parashikimeve të pikës 7, të këtij kreu.

9. Jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e vendimit të shpronësimit dhe/ose të shkëmbimit ose nga data që ka marrë formë të prerë vendimi i gjykatës, me kërkesë të njësisë zbatuese dhe/ose përfaqësuesit të pronarit shtet, në rast se kompensimi kryhet nëpërmjet shkëmbimit të pronës private me një pasuri shtetërore të ardhshme, në kartelën e pasurisë për pronën truall ku do të krijohet pasuria e ardhshme, regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, bëhet regjistrimi i barrës ligjore sipas legjislacionit në fuqi, në favor të pronarit privat, për përfitimin në të ardhmen të pasurisë shtetërore kur kjo e fundit të regjistrohet në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës. Kur pronari/pronarët privat/ë ka/në pranuar kushtet e shkëmbimit, pjesë e kërkesës për regjistrim janë dhe marrëveshjet përkatëse, sipas parashikimeve të pikës 7, të këtij kreu. Me regjistrimin e pasurisë së ardhshme në regjistrin përkatës pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me kërkesë të njësisë zbatuese dhe/ose të përfaqësuesit të pronarit shtet bëhet regjistrimi i kalimit të të drejtave të pronësisë për pronën shtet në favor të pronarit privat.

10. Kur nuk janë lidhur marrëveshjet përkatëse, sipas parashikimit të pikës 7, të këtij kreu, në rast se pronari privat ka detyrimin të paguajë për sipërfaqe shtesë në pronën e re, sipas parashikimeve të kreut II, të këtij vendimi, në kartelën e pasurisë regjistrohet barrë ligjore, e barabartë me vlerën përkatëse të detyrimit. Përfaqësuesi i pronarit shtet dhe/ose njësia zbatuese kryen procedurat e njoftimit dhe të dorëzimit të pronës te pronari privat.

11. Pasuritë pronë private të shpronësuara dhe/ose të shkëmbyera duhet të regjistrohen në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, sipas legjislacionit në fuqi, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit të Këshillit të Ministrave për shpronësimin në pronësi të organit shtetëror përkatës ose njësisë zbatuese, sipas kërkesës së kësaj të fundit.

12. Deri në fillimin e zbatimit të projektit në zonën e re për ndërtim/zhvillim sipas parashikimeve të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, banesat shfrytëzohen nga përfituesit. Gjatë periudhës së zbatimit të projektit (përfundimin e punimeve) subjektet, sipas kreut II, të këtij vendimi, nëse nuk kanë në pronësi ose në posedim objekte të tjera banimi, do të strehohen nga shteti nëpërmjet programeve të rindërtimit, të parashikuara në aktin normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” ose në legjislacionin në fuqi për strehimin social.

13. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ministri i Shtetit për Rindërtimin, njësitë e vetëqeverisjes vendore, njësitë zbatuese dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama